



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:102217
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05595162

C.nr.335/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I.K dhe I.I, te dy nga fshati Krushe e Madhe Komuna e Rahovecit të cilët i përfaqëson avokat D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokat B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës per inflacion, jashtë seancës, me datë 19.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses paditësve I.K dhe I.I, te dy nga fshati Krushe e Madhe Komuna e Rahovecit.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit I.K në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Qershor – Dhjetor 2019 në shumën prej 68.00 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, e në shumën e përgjithshme prej **249.86 euro**, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 20.05.2022 (data e praqitjes se padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit

-DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit I.I në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Qershor – Dhjetor 2019 në shumën prej 68.00 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, e në shumën e përgjithshme prej **249.86 euro**, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 20.05.2022 (data e praqitjes se padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëseve I.K dhe I.I, mbi shumën aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

IV. HEDHET POSHTE si e pa lejuar padia e paditëseve I.K dhe I.I, per periudhen e precizuar per vitin 01.01.2022 e deri 21.11.2022, pasi qe te njejtin kan paraqitur padi tjera ne gjykate per te njejten periudhe kohore dhe gjykata ka ne procedim kerkesat e tyre.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës të autorizuarit te paditëses të i paguajë shumën prej 177.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit I.K dhe I.I, te dy nga fshati Krushe e Madhe Komuna e Rahovecit, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 20.05.2022, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës per inflacion dhe kan paraqitur precizim te padise me daten 24.11.2023.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Bajram Curri” në fshatin Krushe e Madhe, Komuna e Rahovecit. Paditësit kanë precizuar kërkesëpadinë, sipas së cilës ka kërkuar kompensim në emër të inflacion. Ku periudha e kërkuar në emër të inflacionit është nga viti 2019 – 2022. Andaj, i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi, ka theksuar se gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Sa i përket Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021 MASHTI ka shkëputur këtë kontratë me SBASHK. MASHTI me këtë rast ka theksuar se shkëput kontratën njëanshëm bazuar në kornizën ligjore në fuqi, pasi e njëjta është nënshkruar në mungesë të bazës ligjore. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës-paditësit, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Listën e pagave të muajit dhjetor 2021.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko- civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kishin të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve kompensimi nga marrëdhënia e punës me bazë për inflacion, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës-paditësit të dative të ndryshme, të lidhura ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësëve I.K dhe I.I, gjykata vërtetoi faktin se paditësit kan kontratë pune me të paditurën dhe te njëjtit janë të sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Bajram Curri” në fshatin Krushe e Madhe, Komuna e Rahovecit, po ashtu të gjithë paditësit janë në listën e pagave të muajit dhjetor 2021.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen edhe dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve secilit veq e veq i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi per periudhen kohore nga data 01.01.2020 e deri 31.12.2021.

Gjykata vendosi ta refuzojë pjesërisht si të pabazuar kërkesëpadinë, mbi bazën se kemi te bejme me parashkrim të kërkesës në emër të inflacionit që përfshin periudhe kohore prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa për kompensim në emër të inflacionit për këtë periudhë kohore është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 20.05.2022, ndërsa per paditesit tjerë zgjerimi i padise me datën 01.12.2023, kërkesës për kompensim në emër të inflacionit për këtë periudhë kohore te vitit 2019 është parashkruar, pasi që precizimi i padisë (zgjerimi i saj) me ane të se cilës është kërkuar kompensimi në emër të inflacion është parashtruar me datën 24.11.2023.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditëseve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi pjesërisht pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës.

Gjykata vendosi ta hudhe poashte si te pa lejuar padia e paditëseve I.Kdhe I.I, per periudhen e precizuar per vitin 01.01.2022 e deri 21.11.2022, pasi qe te njejtin kan paraqitur padi tjera ne gjykate per te njejten periudhe kohore dhe gjykata ka ne procedim kerkesat e tyre, ndersa ne padin fillestare pa e precizuar te njejtin kan perfshire periudhen kohore te vitit 2017-2021.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: “Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën V të

dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 177.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 156.00 euro, si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.335/2022, më 19.04.2024

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.